



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/26
Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 3 dhe 4 dhe nenit 137 paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.04/L-219 për të Huajt, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 01/2015 për përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurën e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt (në tekstin në vijim: Komisioni).

1. Komisioni ka këtë përbërje:

1.1. Agron Gashi ZKM,	kryesues;
1.2. Burbuqe Spahija - Kërveshi MD,	zv.kryesuese;
1.3. Avdyl Hyseni MPB,	anëtar;
1.4. Zenel Gashi MPJ,	anëtar;
1.5. Minire Begaj, MPMS,	anëtare;
1.6. Rexhep Bllaca MTI,	anëtar;
1.7. Isni Kryeziu, MASHT,	anëtar.
2. Komisioni është i pavarur në punën e tij.
3. Komisioni mund të vendos për rastet edhe në panel prej 3 (tre) anëtarësh, dhe i njëjti merr vendime me shumicë votash.
4. Përfaqësuesi i UNCHR-it mund të merr pjesë në punën e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.
5. DSHAM/MPB luan rolin e sekretariatit të Komisionit dhe të njëjtit i ofron kushtet teknike për ushtrimin e përgjegjësisë.
6. Komisioni gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë e zbaton Ligjin në fuqi për të Huajt dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Ligjin në fuqi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik si dhe legjislacionin tjetër i cili është relevant në ushtrimin e përgjegjësisë së Komisionit.

7. Obligohen Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
8. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë të përgatis plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 01/2015 për përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurën e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/185 i datës 25.04.2014, Për themelimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave që parashtrihen nga të huajt në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/26

Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. sc. Fejzullah Hasani kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën e Drejta Penale (material dhe procedural), zëvendësanëtar i Komisionit z. Ramë Gashi;
 - 1.2. Dr. sc. Abdulla Aliu, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën E drejta civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore dhe e detyrimeve, zëvendësanëtar i Komisionit Adem Vokshi;
 - 1.3. Ilaz Ramajli, anëtar i Komisionit, pyetës nga lënda E drejta tregtare, zëvendësanëtare e Komisionit Fetije Sadiku;
 - 1.4. Nebojsa Boricic, anëtar i Komisionit, pyetës nga lënda E drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të drejtat e njeriut, zëvendësanëtar i Komisionit Visar Morina, dhe
 - 1.5. Mirlinda Batalli, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës E drejta e punës dhe e drejta administrative, zëvendësanëtar i Komisionit Rafet Haxhaj.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për emërim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/26

Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për komunën e Mitrovicës Veriore pas ri-aprovimit të Buxhetit për vitin 2015 nga Kuvendi Komunal Mitrovicë Veriore me datë 27 Prill 2015.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Mitrovicës Veriore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/26

Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për komunën e Leposaviqit pas ri-aprovimit të Buxhetit për vitin 2015 nga Kuvendi Komunal Leposaviq me datë 27 prill 2015.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Leposaviqit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/26

Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për komunën e Zubin Potokut pas ri-aprovimit të Buxhetit për vitin 2015 nga Kuvendi Komunal Zubin Potok me datë 27 prill 2015.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Zubin Potokut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/26

Datë: 04.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për komunën e Zveçanit pas ri-aprovimit të Buxhetit për vitin 2015 nga Kuvendi Komunal Zveçan me datë 27 prill 2015.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Zveçanit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë